



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 12 AKTI

NR. 41 VENDIMI

Tiranë, më 18.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, më datë 16.07.2018, ora 13:00, zhvilloi në katin e dytë të Pallatit të Koncerteve seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Artan Zeneli, gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore, si dhe shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi:

V Ë R E N:

Z. Artan Zeneli është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017 me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga komisioneret Etleda Çiftja, Xhensila Pine relatores dhe Valbona Sanxhaktari.

Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “KLD”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues nr. 4 me vendimin nr.1, datë 12.12.2017, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të caktojë me mirëkuptim kryesuesin e trupit gjykues, komisionere Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

Më datë 06.06.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe të drejtat që ai si subjekt i rivlerësimit gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

Subjekti i rivlerësimit paraqiti, më datë 07.06.2018, kërkesën e tij për përjashtimin e relatores së çështjes. Kjo kërkesë u shqyrtua nga një trup tjetër gjykues, i caktuar me short, që me vendimin e datës 12.06.2018, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të rrëzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli.

Më datë 18.06.2018, trupi gjykues nr. 4, me vendimin nr. 2, vendosi:

- (i) Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84 /2016, të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, duke arritur në përfundimin se provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këto dy kriteret bazuar në nenin 52, paragrafi i dytë i ligjit nr. 84/2016;
- (ii) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të pikës 5 të nenit D dhe pikës 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016;
- (iii) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, dhe të drejtën për të marrë një kopje të tyre, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative;
- (iv) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

Më datë 19.06.2018, u njoftua subjekti i rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit; (ii) kalimin e barrës së provës; (iii) të drejtën për njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të drejtën e tij për të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*.

Më datë 23.06.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, kërkoi t'i vihej në dispozicion metodologjia e llogaritjeve financiare të kryera nga ana e Komisionit, si kërkoi një shtim të afatit për të paraqitur mbrojtjen, për arsye të marrjes së kësaj metodologjie.

Më datë 25.06.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, vendosi t'i vërë në dispozicion subjektit të rivlerësimit metodologjinë e përmbledhur të llogaritjeve financiare, si dhe të shtojë me 5 ditë shtesë afatin e paraqitjes së shpjegimeve të subjektit të parashikuar prej 15 ditësh në vendimin nr. 2 të trupit gjykues.

Më datë 09.07.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e tij së bashku me provat.

Më datë 12.07.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 4, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 16.07.2018, ora 13:00, pranë Pallatit të Koncerteve, kati i 2-të, Tiranë.

Më datë 16.07.2018, ora 13:00, pranë Pallatit të Koncerteve, kati i 2-të, Tiranë, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli.

Në këtë seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit i paraqiti trupit gjykues kërkesën për përfshirjen edhe të komponentit të tretë, atë të vlerësimit profesional, për të, si subjekti i rivlerësimit.

Trupi gjykues në dhomë këshillimi, në prezencë edhe të përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, vendosi me shumicë votash, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli pasi për komponentët e figurës dhe të pasurisë, provat kishin nivelin e provueshmërisë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe provat e paraqitura nuk arriti të provojë të kundërtën.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë vendim në seancë dëgjimore.

Marrja e vendimit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Artan Zeneli, mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit profesional.

PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Në referim të dispozitave ligjore kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2 e 17 të vitit 2017, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, si më poshtë vijon:

KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duke dërguar me shkresën me nr. *** prot., datë 31.10.2017, raportin për kontrollin e figurës. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit z. Artan N. Zeneli, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan N. Zeneli.

Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, DH, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 34-39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe vendimet nr. 2 e nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, në vijim të procesit të kontrollit të figurës, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kreu një hetim administrativ të thelluar, për kontrollin e figurës, së subjektit

të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve dhe kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me parashikimet ligjore, nga ku rezultoi:

1. Faktet nga hetimi administrativ:

1.1 Raporti i DSIK-së kishte si datë të plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës datën 16.01.2017.

1.2 Iu kërkua informacion shtesë DSIK-së për datën e saktë se kur subjekti i rivlerësimit e kishte dorëzuar këtë deklaratë, pasi nga parashikimet ligjore dhe mbështetur në faktin që data e plotësimit të deklaratës nga subjekti i rivlerësimit ishte bërë brenda periudhës kur ligji ishte i pezulluar¹ dhe pa u shprehur Gjykata Kushtetuese me vendim, e gjatë kësaj periudhe as subjektet e rivlerësimit dhe as institucionet nuk kishin si të kryenin veprime për depozitimin e deklaratave të parashikuara në ligjin 84/2016.

1.3 Për sa më sipër u konfirmua nga ana e DSIK-së se dorëzimi sipas ligjit i deklaratës së kontrollit të figurës nga subjekti i rivlerësimit ishte bërë më datë 27.01.2017.

Grupi i Punës, në vlerësim të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli, me shkresën nr. *** prot., datë 09.03.2018, paraqiti raportin e rishikuar për subjektin e rivlerësimit, si më poshtë:

“Në vlerësim të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit, gjykohet se: referuar parashikimeve të bëra në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në nenin DH “Kontrolli i figurës”, pika 4, subjekti i rivlerësimit, Artan N. Zeneli, evidentohet se ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës, konkretisht në germën “g” të pjesës nr.5, “Të dhëna për sigurinë”. Mosdeklarimi në këtë rast, e ngarkon subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli, me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe me plotësimin jo me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës.

1.4 Në vijim të hetimit administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 12.04.2018, iu kërkua DSIK-së informacion për sa më poshtë:

a) Nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë prezent personalisht në datën 27.01.2017 në ambientet e DSIK-së apo kjo deklaratë është dorëzuar nga një person tjetër i autorizuar prej tij.

b) Informacion mbi procedurën e marrjes në dorëzim të kësaj deklarate, duke dhënë sqarime për hapat e ndjekur nga verifikimi i subjektit të rivlerësimit deri te nënshkrimi i subjektit.

1.5 Në përgjigje të kërkesës së informacionit sa më sipër, DSIK-ja, me shkresë nr. *** prot. datë 16.04.2018, duke paraqitur kopje të faqes së regjistrimit të dorëzimit të formularit, informoi Komisionin se:

*“Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, e ka dorëzuar deklaratën më datë 27.01.2017 dhe ka numër protokollit ***. Në këtë regjistër është nënshkrimi i tij dhe emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit të DSIK-së”.*

¹Pas miratimit nga Parlamenti, ligji hyri në fuqi më datë 8.10.2016. Në datë 25.10.2016, mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vendosi pezullimin e zbatimit ligjit nr.84/2016 dhe kërkimin e *amicus curia* nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e tij me Koventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në datë 18.01.2017, me vendimin nr.2 të saj Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në dt.19.01.2017.

“Çdo subjekt i rivlerësimit e ka dorëzuar vetë dokumentacionin përkatës në DSIK, duke u paraqitur vetë fizikisht dhe me kartë identiteti. Në regjistër kanë firmosur vetë personalisht fizikisht subjekti dhe punonjësi marrës i DSIK-së. Subjektet janë pajisur me një vërtetim ku shënohej numri i protokollit sipas regjistrit përkatës dhe data e dorëzimit të dokumentacionit.

Gjatë dorëzimit të dokumentacionit nga çdo subjekt rivlerësimi kanë qenë prezent jo më pak se tre anëtarë të strukturës provizore të ngritur për këtë qëllim nga DSIK”.

1.6 Me shkresën e DSIK-së, nr. *** prot., datë 14.05.2018, të deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. *** prot., datë 30.05.2018, u informua Komisioni se subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, i është revokuar viza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më datë 26.01.2017. Sipas kësaj shkrese, në të njëjtën datë, 26 janar 2017, në orën 15:00, z. Artan Zeneli kishte marrë personalisht dijeni mbi revokimin e vizës.

1.7 Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë në garantim të të drejtave të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, mbasi hetoi këto fakte, kërkoi sqarime të mëtejshme nga ana e subjektit të rivlerësimit.
1.8 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se më datë 16.01.2017, kishte paraqitur kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar në përbërjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe se njëri nga dokumentet e nevojshme ishte edhe “Shtojca 3” në formën e formularit që përmbante Deklaratën për Kontrollin e Figurës, të cilin e kishte paraqitur në kopje, ndërsa origjinalin do ta paraqiste në DSIK, pasi të rifillonte të ecte afati për paraqitjen e dokumenteve dhe të binte masa e pezullimit, e vendosur nga Gjykata Kushtetuese. Kjo ishte edhe arsyeja që deklarata mbante datën 16 janar 2017.

1.9 Më datë 26.01.2017, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ishte thirrur për intervistë në Konsullatën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe, po në atë datë, është njoftuar për revokimin e vizës private B1/B2. Më datë 27.01.2017, kishte dorëzuar origjinalin e deklaratës për kontrollin e figurës në DSIK, të plotësuar më datë 16.01.2017.

1.10 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në këto shpjegime se nuk e çmoi të bënte ndryshime në formularin e deklaratës për kontrollin e figurës për arsye se ishte i bindur se nuk i ishte refuzuar hyrja, por thjesht ishte revokuar njëra nga vizat, si edhe për faktin se kishte ende në fuqi një vizë tjetër amerikane, të tipit “A1”.

2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve

- Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Kontrollit të Figurës “Vetting”;
- Shkresë nr. *** prot., datë 31.10.2017, e raportit për kontrollin e figurës, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. ***, datë 08.01.2018;
- Shkresë nr. *** prot., datë 09.03.2018, nga DSIK-ja për dërgimin e raportit për kontrollin e figurës, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, datë 28.03.2018;
- Shkresë nr. *** prot., datë 12.04.2018 drejtuar DSIK-së
- Shkresë nr. *** prot., datë 16.04.2018, nga DSIK;
- Shkresë nr. *** prot., datë 31.05.2018, nga DSIK;
- Shkresë nr. *** prot. datë 14.05.2018, deklasifikuar pjesërisht me KDZH-në më 30.05.2018;
- Shkresë nr. *** prot., datë 16.04.2018, drejtuar Konsullatës së Ambasadës Amerikane;
- Përgjigje e Ambasadës Amerikane me shkresën e datës 2 maj 2018;
- Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe kopje të provave shkresore në rrugë elektronike;
- Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore më datë 16.07.2018.

3. Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Kontrollit të Figurës “Vetting”; (ii) raportet e DSIK-së, si dhe prova shkresore të DSIK-së; (iii) provat shkresore dhe faktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ; (iv) shpjegimet dhe provat e

dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, Komisioni arsyeton se:

3.1 Neni DH, paragrafi 2, i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit sipas ligjit”*.

Më tej, neni DH, paragrafi 4, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*.

3.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të deklaramit të refuzimit të hyrjes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (vend anëtar i NATO-s), në zbatim të parashikimeve ligjore të germës “g”, pjesa 5, të “Shtojcës 3” të ligjit nr. 84/2016, duke mos e pasqyruar këtë fakt të ndodhura deri në ditën e deklaramit, në përgjigjen e dhënë pyetjes, nëse gjatë 10 viteve të fundit i është refuzuar hyrja në ndonjë vend të BE-së/NATO-s.

3.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën e Kontrollit të Figurës, plotësuar, nënshkruar e dorëzuar në DSIK, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, se:

a)Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të NATO-s, ndërkohë që Konsullata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i ka revokuar vizën turistike “B1/B2”.

b)Është i ndërgjegjshëm se, mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i Deklaratës për Kontrollin e Figurës mund të passjellë shkarkimin e tij nga detyra, sipas ligjit.

3.4 Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, se kishte pyetur në ambasadë se cila vizë i ishte revokuar dhe ishte informuar se ishte revokuar vetëm një vizë, e se tjetra ishte e vlefshme, nuk e përjashton atë nga detyrimi ligjor për t’iu përgjigjur saktë e me vërtetësi pyetjes, të parashikuar në germën “g”, të pjesës 5, të “Shtojcës 3” të ligjit nr. 84/2016.

Kjo pyetje nuk i referohet një numri të caktuar të vizave, të vendeve apo pasaportave. Një revokim i vetëm një vize ngarkon subjektin e rivlerësimit me detyrimin ligjor, që pyetjes “Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë vend të BE-së/NATO-s?” t’i përgjigjet me “Po”, për të përmbushur detyrimin e plotësimit saktë e me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës.

3.4.1 Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se nuk e çmoi të bënte ndryshime në formularin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës për arsye se ishte i bindur se nuk i ishte refuzuar hyrja, por thjesht i ishte revokuar njëra nga vizat, për arsye teknike, nuk përputhet me qëndrimin e bërë publik të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në datën 26 janar 2017, sipas të cilit:

“Ambasada e Shteteve të Bashkuara ka revokuar vizat joemigruese për disa gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë, pasi ka dalë në përfundimin që këta zyrtarë nuk kualifikohen për këto viza. Për shkak se të dhënat e vizave janë konfidenciale, sipas ligjit të Shteteve të Bashkuara, ne nuk mund të komentojmë mbi raste individuale. Ambasada e Shteteve të Bashkuara e ka ndërmarrë këtë veprim përpara procesit të pritshëm të vetting-ut, i cili do të vlerësojë lidhjet e zyrtarëve të caktuar me korrupsionin, si dhe në përgjigje të një rasti që përfshinte abuzim flagrant të një vize zyrtare nga një prokuror i nivelit të lartë dhe bashkëshortja e tij, gjë që çoi në revokimin e vizave të tyre.

3.4.2 Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se, sipas tij, revokimi nuk është refuzim hyrjeje në një shtet të NATO-s, është vetëm interpretim i tij e nuk përputhet me qëndrimin e bërë publik të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në datën 26 janar 2017, sipas të cilit:

“Ambasada e Shteteve të Bashkuara i merr seriozisht akuzat për korrupsion dhe do të vazhdojë t’i shqyrtojë vizat dhe aplikimet për vizë të zyrtarëve të drejtësisë me vëmendje të shtuar. Departamenti

i Shtetit ka një autoritet të gjerë për të mohuar dhe revokuar viza, bazuar në informacione që tregojnë se zotëruesi i vizës mund të jetë i papranueshëm në Shtetet e Bashkuara dhe Departamenti i Shtetit do të vazhdojë ta përdorë këtë autoritet për t'i çuar përpara përpjekjet kundër korrupsionit në Shqipëri.”

3.5 Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, se kishte paraqitur një kopje të “Shtojcës 3” në formën e formularit që përmbante Deklaratën për Kontrollin e Figurës në kohën që kishte paraqitur kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar në përbërjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa origjinalin do ta paraqiste në DSIK, pasi të rifillonte të ecte afati për paraqitjen e dokumenteve, nuk është i bazuar në ligj e prova, pasi:

3.5.1 Gjatë hetimit të kryer Komisioni konstatoi se për shprehjen e interesit për të kandiduar në përbërjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, subjekti i rivlerësimit bazuar në nenin 10, pika 3/c, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes se sistemit të drejtësisë”, ka plotësuar e dorëzuar formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

3.5.2 Deklarata e Kontrollit të Figurës është plotësuar e dorëzuar në DSIK, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe në bazë të kërkesave të këtij ligji.

3.5.3 Deklarata e Kontrollit të Figurës si dhe Formulari i vetëdeklarimit të parashikuara në pikat “3.5.1” e “3.5.2”, janë të ndryshme në emërtim, formë, përmbajtje, si dhe në bazë ligjore.

3.5.4 Deklarata e Kontrollit të Figurës, si dhe Formulari i Vetëdeklarimit, përbëjnë dokumente zyrtare të miratuara, që duhet të paraqiten në origjinal e jo në kopje organit shtetëror që i drejtohen (për formularët e “3.5.1” e “3.5.2” këto organe kanë qenë të ndryshme). Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit për dorëzimin e të njëjtit formular (një herë kopje e një herë origjinal) është i pabazuar në ligj e fakte.

3.5.5 Deklarata e Kontrollit të Figurës si dhe Formulari i vetë deklarimit, të parashikuara në pikat “3.5.1” e “3.5.2”, duhet të plotësohen me vërtetësi e saktësi, me fakte e të dhëna të ndodhura deri ditën e deklarimit të tyre sipas ligjit.

3.5.6 Për sa më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës, në lidhje me deklarimin e pasaktë në Deklaratën e Kontrollit të Figurës, deri në ditën e deklarimit, sipas parashikimeve ligjore.

4. Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklarimit, sipas ligjit.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar Formularin e Deklarimit për Kontrollin e Figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germës “g”, të pjesës 5, të “Shtojcës 3” “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016.
- (iii) Bazuar në nenin 61/3 subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, pasi nuk ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë e me vërtetësi, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit 84/2016.

Konkluzioni për vlerësimin e figurës

Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan N. Zeneli, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës, duke mos plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi dhe duke fshehur fakte e rrethana të ndodhura para deklaramit sipas ligjit të këtij formulari.

Në zbatim të pikës 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë rezultateve të hetimit.

VLERËSIMI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja është bërë pas marrjes së deklaramtës së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, dorëzuar në ILDKPKI, më datë 31.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDKPKI-ja ka hartuar dhe dërguar raportin e detajuar lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarami është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vendimet nr. 2 e nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu hetimin e tij të pavarur² në vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje pasurie, deklaram të rremë.

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, rezulton se ka në pronësi pasuritë e paluajtshme:

I. Banesë me sip. 260 m² dhe 300 m² oborr, në Tiranë, *, vlera 196.738 euro.**

Burimi i krijimit i deklaram në Deklaramtën - Vetting:

Të ardhurat si avokat dhe paga e bashkëshortes, Kontratë kredie bankare dhe hipoteke me “Raiffeisen Bank”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.01.2008, për kredi, në shumën 150.000 euro.

1. Faktet nga hetimi administrativ

1.1. Referuar kontratës për ndërtim vile, datë 04.06.2007, midis shoqërisë “***” dhe porositësit, subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli: çmimi i sipërmarrjes për ndërtim vile, është në total 196.738 euro, është paguar me nënshkrimin e kësaj kontrate. (2007)

² “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozitë ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

1.2 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (nr. indeksi *** pranë ILDKPKI-së), me datë dorëzimi 01.11.2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi se e ka paguar të gjithë vlerën e kësaj prone.

1.3 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (pranë ILDKPKI-së, nr. *** indeksi) me datë dorëzimi 01.11.2007, subjekti i rivlerësimit në “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, nuk ka të deklaruar detyrime financiare ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.

1.4 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (pranë ILDKPKI-së, nr. ***indeksi), me datë dorëzimi 01.11.2007, subjekti i rivlerësimit në formularin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, nuk ka të deklaruar detyrime financiare ndaj shtetasit G. S.

1.5 Shoqëria “****” sh.p.k. vuri në dispozicion të Komisionit, kopjen e kontratës me z. Artan Zeneli për ndërtim vile, nr. *** rep., nr. ***kol., datë 04.06.2007, lidhur përpara noterës E.H.

1.6 Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, të nënshkruar nga palët, çmimi i plotë i vilës, prej 196.738 eurosh, u pagua me nënshkrimin e kësaj kontrate.

1.7 Kontrata e kredisë bankare lidhur mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe “Raiffeisen Bank” u lidh në datën 08.01.2008, disbursimi i shumës 150.000 euro në llogari të bashkëshortes u krye më datë 10.01.2008.

1.8 Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, shuma prej 150.000 eurosh, përfituar nga disbursimi i kredisë, ka kaluar me transfertë më datë 04.02.2008 në llogari të ortakut dhe jo në llogari të shoqërisë ndërtuese.

1.9 Referuar analizës financiare për subjektin e rivlerësimit z. Artan Zeneli, për këtë periudhë rezultoi se ka pasur mungesë të burimeve financiare për likuidimin e kësaj pasurie në vlerë 23.958.754 lekë (196.738 euro*121.78 l/euro), si dhe shpenzime për kredi të paguara në vlerë 1.290.883 lekë në vitin 2007, kur të ardhurat vjetore rezultojnë në vlerë 9.974.794 lekë.

1.10 Sa më sipër, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për mospërputhje në lidhje me:

- i) Pagesën për këtë pronë;
- ii) Sipërfaqen e oborrit të kësaj prone;
- iii) Kalimin e çmimit të blerjes.

2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve

- Shkresë nr. ***prot., datë 11.01.2018, ZVRPP-së;
- Shkresë nr. ***, datë 12.01.2018, OSSHE-së;
- Shkresë nr. *** prot., datë 13.02.2018, drejtuar “****” sh.p.k.;
- Kthim përgjigje nga shoqëria “****” sh.p.k., nr. *** prot., (pa datë), protokolluar me tonë nr. *** prot., datë 02.03.2018;
- Kontratë për ndërtim vile, nr. *** rep., nr. ***kol., datë 04.06.2007, notere E. H.;
- Shkresë kthim përgjigje ILDKPKI-së nr. ***prot., datë 20.04.2018;
- Kthim përgjigjes nga shoqëria “****” sh.p.k., me nr. *** prot., datë 28.02.2018;
- Deklaratë noteriale e z. G. S, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2018;
- Akt ekspertimi i shoqërisë “****”, ekspert T. Gj.;
- Shkresë me nr. *** prot., datë 04.12.2017 – “Raiffeisen Bank”;
- Tabelat për shlyerjen e kredive për “Raiffeisen Bank”;
- Deklarata e pasurisë së subjekti të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- Deklarata e interesave private para fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së me nr. indeksi ***;
- Deklaratat e interesave private periodik/vjetor nga vitit 2007 deri në 2016-ën, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar;
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe dokumentacionet e provat e depozituara nga subjekti i

rivlerësimin në rrugë elektronike;
- Parashtrimet e subjektit të rivlerësimin në seancën dëgjimore të datës 16.07.2018.

Trupi gjykues, e konsideroi marrjen e dëshmisë së z. G. S, i datëlindjes 29.07.1970, të panevojshme për vendimmarrjen, pas marrjes si provë të deklaratës noteriale të z. G. S, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2018.

Trupi gjykues, e konsideroi të panevojshme për vendimmarrjen, kryerjen e veprimeve procedurale për këqyrjen e sipërfaqes së parcelës oborrit dhe sipërfaqes nën këtë ndërtesë, për arsye se fakti që kërkohej të provohet rezultoi i provuar gjatë gjykimit.

3. Arsyetimi ligjor

3.1 Për sa i përket sipërfaqes së oborrit:

Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimin për sipërfaqen e oborrit të kësaj banese, i konsideron ato të plota, duke e quajtur të provuar të kundërtën e barrës së provës, për këtë pikë të rezultateve të hetimit për subjektin e rivlerësimin, z. Artan Zeneli.

3.2 Për sa i përket pagesës për këtë pronë dhe kalimit të çmimit të blerjes:

3.2.1 Deklarata noteriale e z. G. S, paraqitur si provë, ka vlerë të kufizuar provuese; së pari, ajo është bërë nga njëra prej palëve në kontratë dhe një person në marrëdhënie shoqërore me subjektin e rivlerësimin dhe është bërë gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, sipas kërkesës së vetë subjektit; së dyti, pasi pas analizimit të saj u vërejt se:

3.2.2 Kjo deklaratë noteriale, e bërë nga ortaku i kompanisë, bie ndesh me çfarë është deklaruar nga shoqëria “****” sh.p.k., me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., me anë të së cilës kjo shoqëri informon Komisionin se:

“Detyrimi kontraktor prej 196.738 eurosh është likuiduar nga z. Artan Zeneli në këstet si më poshtë:

i. Kësti i parë, prej 46.738 eurosh, është paguar nga klienti me nënshkrimin e kontratës për ndërtim vile;

ii. Kësti i dytë, prej 150.000 eurosh, është paguar nga klienti nëpërmjet kredisë bankare më datë 04.02.2008.

Meqenëse vila nuk është regjistruar, fatura e shitjes do të lëshohet në momentin e shitjes.”

3.2.3 Kjo deklaratë noteriale bie ndesh edhe me deklaratimet e subjektit të rivlerësimin, në përgjigje të pyetësorit të datës 08.03.2018, sipas të cilave ai deklaroi se me lidhjen e kontratës ishte paguar nga ana e tij shuma rreth 46.000 euro në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k., ndërsa pjesa tjetër, prej 150.000 eurosh, ishte paguar me kredi, të marrë për këtë qëllim në “Raiffeisen Bank”. Kredia ishte akorduar në kohën që u lidh kontrata.

3.2.4 Subjekti i rivlerësimin ndryshon shpjegimet e tij, duke deklaruar se, për sa i takon mënyrës së pagesës, pjesa e parë e detyrimit u pagua nga ai me të ardhurat e fituara nga veprimtaria si avokat dhe të ardhurat e bashkëshortes, pjesa tjetër e detyrimit të mbetur, prej 150.000 eurosh, u mor përsipër të parapaguhej personalisht nga ana e ortakut, administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., z. G. S, me qëllim për të përsheptuar realizimin e ndërtimit, derisa të lëvrohej efektivisht kredia bankare dhe më pas, kjo shumë t’i kalonte atij, sapo ajo të disbursohej nga ana e bankës.

3.2.5 Sikundër u provua gjatë hetimit administrativ dhe sikundër vetë subjekti deklaroi në Deklaratën - Vetting, data e nënshkrimit të kontratës së kredisë mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimin dhe “Raiffeisen Bank” ishte data 8 janar e vitit 2008.

3.2.6 Aprovimi në parim i kreditimit nuk e ngarkon as bankën, as klientin me detyrimin për nënshkrimin e kontratës së kredisë dhe palët mund të tërhiqen në çdo kohë prej nënshkrimit të saj, ndaj ajo nuk mund të referohet nga palët si datë e nënshkrimit të kredisë, e aq më pak të përdoret si argument nga subjekti i rivlerësimit.

3.3 Në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të Deklaratës-Vetting dhe deklaramit periodik të vitit 2007, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

-Nuk ka paraqitur si burim për krijimin e kësaj pasurie në Deklaratën -Vetting huan e marrë ortakut të firmës ndërtuese, z. G. S, detyrim ky i konfirmuar edhe nga akti i ekspertimit të shoqërisë “****” (në aneksin 4) nga eksperti T. Gj ;

-Nuk ka paraqitur në deklarin periodik të vitit 2007 vlerën 150.000 euro, si hua e pashlyer ndaj ortakut të shoqërisë ndërtuese, detyrim ky i konfirmuar edhe nga akti i ekspertimit të shoqërisë “****” (në aneksin 4) nga eksperti T. Gj., në kundërshtim me nenin 4, pika “d”, “e” dhe “f” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”;

-Ka ndryshuar deklarin fillestar të kryer në Deklaratën - Vetting, duke përdorur si burim për këtë pasuri të ardhura të marra hua nga ortaku i firmës së ndërtimit;

-Deklarimi për këtë hua, marrë ortakut të firmës ndërtuese, z. G. S, nuk është në përputhje me deklarinet e tij në Deklaratën - Vetting, por dhe gjatë pyetësorëve, ku ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e tij për këstin e parë dhe kredia bankare për këstin e dytë.

4. Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, në përputhje me nenin D, paragrafi 3, i Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë,pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5, i Aneksit të Kushtetutës.
- (iii) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë në Deklaratën-Vetting, pasi nuk ka paraqitur si burim për krijimin e kësaj pasurie huan e marrë ortakut të firmës ndërtuese, z. G. S.
- (iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për pasurinë.

II. Banesë dykatëshe, me sip. 188 m² dhe oborr me sip. 337.25 m², në Rr. “**” .**

Burimi i krijimit i deklaruar në Deklaratën - Vetting:

- Të ardhurat nga paga dhe të prindërve;
- Kontratë dhurimi, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.07.1994.

1. Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Noteri Gj. K vë në dispozicion të Komisionit kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 22.09.2016, mes shitësit Bashkia Tiranë dhe blerësve Artan Zeneli, M. B, R. B, D. L dhe E. P me objekt kalimin në pronësi të blerësve të sip. prej 35.12 m². Vlera e objektit është 164,569 lekë, e likuiduar plotësisht me mandatarkëtim. Pjesa takuese e Artan Zenelit është 3/12.

1.2 ZVRPP Tiranë, me shkresën e datës 17.01.2018, ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme (truall) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.02.2017, te notere M. Sh, sipas së cilës shitësit E. P, E. P dhe D. L i shesin blerësit Artan Zeneli truallin e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, datë 25.10.2016, zona kadastrale ***, me nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, në rrugën “****” me sipërfaqe totale 35.12 m², E. P 2/12 pjesë, dhe D. L 1/12 pjesë, me vlerë totale 587.990 lekë. Sipas kësaj kontrate, Artan Zeneli bëhet pronar i 3/12 pjesë të këtij trualli, +3/12 që ai ka në certifikatë, bëhet me 1/2 pjesë.

1.3 Subjekti i rivlerësimit ka zotëruar këtë shtim të pasurisë në tetor 2016. Pjesa e pasurisë në pronësi të subjektit të rivlerësimit përpara dorëzimit të Deklaratës-Vetting, nuk është përfshirë te pasuritë e deklaruara.

1.4 Iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin në Deklaratën-Vetting të pjesës së shtuar të kësaj pasurie në datën 22.09.2016, pra përpara datës së dorëzimit të Deklaratës-Vetting në datën 30.01.2017.

1.5 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se të gjitha veprimet për privatizimin e saj, për blerjen para noterit, si dhe anën burokratike edhe atë administrative, e kanë ndjekur bashkëpronarët e tjerë. Kjo ka qenë që ka harruar ta deklarojë në Deklaratën-Vetting, sipërfaqen 8,7 m², për të cilën ka paguar një vlerë prej 40.000 lekë të rinj, që është ¼-ta e pagës së tij.

2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve

- Shkresë nr. ***, datë 11.01.2018, ZVRPP-së Tiranë;
- Shkresat datë 22.10.2008 dhe 28.05.2009 e ZVRPP-së Tiranë, drejtuar Zyrës Qendrore;
- Shkresë, datë 17.01.2018, kthim përgjigje nga noteri Gj. K; bashkëlidhur kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 22.09.2016;
- Shkresë nr. *** prot., datë 16.01.2018, e Komisionit;
- Shkresë, datë 17.01.2018, ZVRPP-së Tiranë;
- Deklarata e pasurisë së subjekti të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- Deklarata e interesave private para fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së me nr. indeksi ***;
- Deklaratat e interesave private periodik/vjetor nga 2007 deri në 2016-ën, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar;
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe dokumentacionet e provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike;
- Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 16.07.2018;
- Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme truall, datë 14.01.2017;
- Kontratë shitjeje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.09.2016;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. ***, datë 25.10.2016.

3. Analiza e provave

3.1. Arsyetimi i subjektit të rivlerësimit se, mosdeklarimi i kësaj sipërfaqeje duke mbajtur në konsideratë vlerën e saj konsiderohet nga ana e tij jo si fshehje, por si një harresë, jo e qëllimshme, nuk është në përputhje me detyrimin sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, për të deklaruar çdo pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit përpara dorëzimit të Deklaratës - Vetting.

3.2 Madhësia e sipërfaqes apo shuma e paguar nuk mund të përbëjnë arsye ligjore për përjashtimin nga detyrimi për deklarim të saktë të të gjitha pasurive të subjektit të rivlerësimit sipas detyrimit ligjor.

3.3 Arsyetimi i përdorur nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit procedurat e shitblerjes, si negociatat, hartimi dhe përpilimi i kontratës, i kanë ndjekur bashkëpronarët e tjerë, nuk mund të

merret në konsideratë, pasi subjekti i rivlerësimit ka qenë palë e kontratës së shitblerjes, e ka firmosur vetë këtë kontratë, si dhe ka paguar vlerën e pronës për pjesën takuese.

3.4 Sipas korrespondencës me ZVRPP-në, subjekti ka blerë edhe pjesën takuese për vlerën totale 587.990 lekë, prej tre bashkëpronarëve të tjerë, të cilët i kanë kaluar pronësinë edhe 3/12 pjesë tjetër të së njëjtës sipërfaqe nga kjo pronë, duke e bërë subjektin pronar të 1/2 pjesë të kësaj sipërfaqeje.

3.5 Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit për harresë të paqëllimshme nuk mbështetet në faktet e rrethanat faktike, për më tepër që, në analizë të pikës “3.4”, rezulton që subjekti të ketë pasur një dijeni të shtuar për këtë fakt.

3.6 Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit, se për vitin 2017 në deklarimin periodik është deklaruar ky ndryshim, nuk e përjashton atë nga detyrimi ligjor i deklarimit në Deklaratën-Vetting të sa më sipër.

3.7 Objekt i deklarimit, sipas nenit 3, pika 11, të ligjit nr. 84/2016, janë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

3.8 Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e pasqyrimin në Deklaratën e Pasurisë, sipas “Shtojcën nr. 2”, të ligjit nr. 84/2016 të të dhënave të sakta.

4. Baza ligjore:

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

III. Apartament me sip. 117 m², Rr. “*”, vlera 41.000 USD.**

Burimi i krijimit i deklaruar në Deklaratën – Vetting:

- Të ardhurat nga puna si avokat dhe ato të bashkëshortes.

1. Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Subjekti i rivlerësimit nuk e ka depozituar në dosje kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie nga shoqëria “***” sh.p.k.

1.2 Vlerën 41.000 USD (me vlerë të përafërt 5.658.000 lekë), sipas parashikimeve të kontratës, blerësi ia ka likuiduar shitësit totalisht jashtë zyrës noteriale.

1.3 Referuar analizës financiare të kryer për këtë subjekt rivlerësimi, për periudhën 1991 – 1999, shuma e të ardhurave të përfituara në total nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij është 3.428.378 lekë.

1.4 Duke krahasuar Deklaratën - Vetting me deklaratën para marrjes së detyrës, rezultojnë mospërputhje në lidhje me:

a. Periudhën e blerjes:

a.1 Në deklaratën para marrjes së detyrës deklarohet i blerë ky apartament në 1999.

a.2 Në Deklaratën - Vetting deklarohet i blerë ky apartament në vitin 2000.

b. Pagesën për këtë pronë:

b.1 Në deklaratën para marrjes së detyrës deklarohet se është paguar tërësisht ky apartament në vitin 1999. Ky deklaram përputhet edhe me atë çka përcaktohet dhe në kontratën e blerjes për këtë apartament.

b.2 Në Deklaratën - Vetting deklarohet se është paguar vlera me këste për këtë apartament, deri në 2004.

1.5 Nisur nga çmimi i blerjes së këtij apartamenti (41.000 USD), me vlerë të përafërt 5.658.000 lekë, blerja e kësaj pasurie nuk justifikohet nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë.

Për sa më sipër, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit, i cili shpjegoi si më poshtë:

1.6. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se këtë pasuri në Rr. “****” e kishte blerë në kushte mirëbesimi nga shoqëria “****” sh.p.k., me ortak të vetëm z. A. Gj, me të cilin kishte marrëdhënie shoqërore.

1.7 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se sa i takon mospërputhjes në dukje të periudhës së blerjes, është lapsus në hedhje të të dhënave në tabelën e deklaramit të pasurisë për procesin rivlerësimit, meqenëse nuk dispononte kontratën e blerjes në momentin e plotësimit të kësaj deklarate dhe në certifikatën e pronësisë nuk përmendej data e blerjes, kishte gabuar në llogaritjen e vitit të saktë të realizimit të kontratës.

1.8 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në maj të vitit 1999 kishte shfaqur interesin për blerjen e një apartamenti nga shoqëria “****” sh.p.k. Së bashku me administratorin dhe ortakun e vetëm të shoqërisë, kishin rënë dakord që detyrimin për shlyerjen e apartamentit ndaj shoqërisë ta merrte përsipër ta paguante z. A. Gj, ndërsa ai do t’i paguante me këste këtij të fundit.

1.9 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se periudha e blerjes së kësaj pasurie përkundrejt shoqërisë “****” sh.p.k. është në vitin 1999, kur ka marrë në dorëzim apartamentin. Ndërsa marrëdhënia e detyrimit midis tij dhe z. A. Gj ka vijuar gjatë viteve në vijim dhe për afatet e pagesës kanë rënë dakord që t’ia shlyente gradualisht shokut, z. A. Gj, në varësi të të ardhurave prej punës që do të kryente si avokat.

1.10 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se, edhe sipas konfirmimit të dhënë nëpërmjet deklaramit noteriale nga ana e z. A. Gj, në vitin 1999, ka paguar në momentin e lidhjes së kontratës 8.000 USD, në vitin 2000 ka paguar te z. A. Gj 4.000 USD, në vitin 2001, përsëri 4.000 USD, në vitin 2002 po 4.000 USD dhe në vitin 2004 i ka paguar atij edhe 21.000 USD.

1.11 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se për mënyrën e pagesës dhe afatet e kësteve kishte rënë në një marrëveshje, e cila për sa kohë ka funksionuar midis palëve dhe në marrëdhënie mirëbesimi, nuk përbënte asnjë shkelje ligjore dhe ndonjë qëllim fshehjeje, për faktin se sipas Kodit Civil ky veprim juridik nuk është i ndaluar.

1.12 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se sipas përlllogaritjes së bërë të të ardhurave dhe shpenzimeve nga shoqëria “****”, me ekspert T. Gj., rezulton se i ka pasur të gjitha mundësitë financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve

- Shkresë nr. ***prot., datë 11.01.2018, ZVRPP-së Tiranë;
- Shkresë nr. *** prot., datë 11.01.2018, me të cilën ZVRPP-ja përcjell kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.05.1999, te notere Sh. K;
- Shkresë nr. ***prot., datë 12.01.2018, OSHEE-së;
- Kontratë shitblerjeje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.05.1999, notere Sh.K;
- Deklaratë noteriale e z. A. Gj, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.07.2018;

- Akt ekspertimi, shoqëria “****”, ekspert T. Gj.;
- Deklarata e pasurisë së subjekti të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016;
- Deklarata e interesave private para fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së me nr. **** indeksi;
- Deklaratat e interesave private periodik/vjetor nga 2007 deri në 2016-ën, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe dokumentacionet e provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike;
- Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 16.07.2018;
- Tabelë për shlyerjen e kredisë, “Emporiki Bank”.

Trupi gjykues e konsideroi marrjen e dëshmisë së z. A. Gj, si të panevojshme për vendimmarrjen, pas marrjes si provë të deklaratës noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., të datës 05.07.2018, të z. A. Gj.

3. Arsyetimi ligjor

3.1 Në lidhje me mospërputhjet për periudhën e blerjes së kësaj pasurie trupi gjykues, pasi analizoi provat e shpjegimet e subjekti të rivlerësimit, i konsideron ato të mjaftueshme e të plota, duke e quajtur të provuar të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli.

3.2 Në lidhje me pagesën e kësaj pasurie trupi gjykues, arsyeton se:

3.2.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën para marrjes së detyrës, deklaroi se e ka blerë këtë apartament në 1999-ën dhe e ka paguar tërësisht. Ky deklaram përputhet edhe me atë çka përcaktohet në kontratën e blerjes. Ky deklaram bie në kontradiktë me atë çka ai deklaroi në Deklaratën-Vetting, ku thotë se apartamentin e ka blerë në vitin 2000 dhe e ka paguar me këste deri në 2004.

3.2.2 Subjekti i rivlerësimit, pasi u pyet nga Komisioni në pyetësor, deklaroi se i ka shlyer detyrimet për këtë pasuri, sipas parashikimeve të kontratës, për çmimin prej 41.000 USD. Më pas, vetëm pas kalimit të barrës së provës, deklaroi se ka vijuar me pagimin e detyrimit për pagesën, të shtrirë në vite, jo për shoqërinë ndërtuese, por për ortakun e saj, z. A. Gj, sipas një marrëveshjeje të padeklaruar më parë.

3.2.3 Deklarata noteriale e z. A. Gj ka vlerë të kufizuar provuese, pasi është bërë nga njëra prej palëve në kontratë dhe një person në marrëdhënie shoqërore me subjektin e rivlerësimit dhe është bërë më pas, sipas kërkesës së vetë subjektit të rivlerësimit.

3.2.4 Pas analizimit të aktit të ekspertimit të ekspertit kontabël T.GJ., për të provuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurisë, rezulton se:

-Për kryerjen e këtij akti-ekspertimi nuk është përmendur asnjë standard auditimi referues për mënyrën dhe zhvillimin e ekspertimit dhe janë përdorur të dhëna referuese të ndryshme për kohën dhe vlerat e paguara;

-Nga shoqëria ndërtuese nuk është paraqitur asnjë dokumentacion provues për likuidimin e shumës 41.000 USD;

-Në kryerjen e këtij akt-ekspertimi është marrë për bazë deklarata noteriale e z. A. Gj, e cila, sikundër u shpjegua në pikën “3.2.3”, ka vlerë të kufizuar provuese, si rrjedhojë edhe akti i ekspertimit i bazuar mbi këtë deklaratë, do të ishte i kufizuar në fuqinë e tij provuese;

-Në këtë akt-ekspertim janë analizuar shpenzimet e familjes së subjektit të rivlerësimit, duke përcaktuar se për një periudhë 25-vjeçare kjo familje ka 55.314.982 lekë shpenzime, pa bërë llogaritje të saktë se si është arritur në një vlerë të tillë dhe pa e shoqëruar këtë llogaritje me dokumentacion ligjor provues;

-Ky akt-ekspertimi nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

4. Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, në përputhje me nenin D, paragrafi 3, i Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (iii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

IV. Apartament banimi me sip. 212.66 m², Rr. “**”, Pall “****”, Tiranë.**

Vlera 100.000 USD. Burimi i krijimit i deklaruar në Deklaratën - Vetting:

- Të ardhurat nga puna si avokat dhe paga e bashkëshortes (paguar me këste).

1. Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Në emër të z. Artan Zeneli figurojnë të regjistruara pasuritë:

1) Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 135.72 m², kontratë shitjeje, viti 2017 (pasuri aktive);

2) Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 60.17 m², kontratë shitjeje viti 2017 (pasuri aktive).

1.2 Shoqëria “****” sh.p.k. konfirmon marrjen me qira nga subjekti i rivlerësimit të ambientit 212.66 m², për një periudhë dyvjeçare, që ka filluar të zbatohet në datën 01.01.2016 dhe ka përfunduar në datën 31.12.2017.

1.3 OSHEE me shkresën kthim përgjigje me nr. *** datë 12.01.2018 konfirmon në emër të Artan Zeneli tre kontrata të furnizimit me energji elektrike në adresën Rr. ***, Pall ***, përkatësisht TR***, TR*** dhe TR***.

1.4 Referuar kontratës së sipërmarrjes së datës 15.11.2002 mes sipërmarrësit shoqërisë “****” sh.p.k, dhe porositësit Artan Zeneli, objekti i kësaj kontrate është apartamenti i ndodhur në katin e 7-të me sip 212.66 m², dhe vlera e tij 100 000 USD.

1.5 Ky apartament është deklaruar me këtë sipërfaqe dhe këtë vlerë nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratën vetting.

1.6 Po ashtu, sipërfaqja prej 212.66 m², konfirmohet e marrë me qera nga Shoqëria “****” shpk për një periudhë dy vjeçare të apartamentit në katin e 7-të me sip 212.66 m², që ka filluar të zbatohet në datën 01.01.2016 dhe përfundon në datën 31.12.2017.

1.7 Nga ana tjetër, referuar kontratës së shitblerjes nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 11.05.2017 përpara noteres M. Sh, mes shitësit P. F dhe blerësit Artan Zeneli, objekti i kësaj kontrate është

shitja e dy ambjenteve me sipërfaqe 135.72 m2 dhe 60.17 m2 me vlere 100 000 USD, pagesë që sipas kësaj kontrate është bërë sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** Rep., datë 15.11.2002.

1.8 Subjekti i rivlerësimit deklaron, në përgjigje të pyetësorit të dërguar, se pagesa për këtë pasuri është bërë me këste, sipas kontratës së sipërmarrjes. Nga sa më sipër, rezulton se janë paguar:

Kësti i parë, 52.000 USD, në datën e nënshkrimit të kontratës, më 15.11.2002;

Kësti i dytë, 25.000 USD, me para në dorë, brenda datës 31.05.2003;

Kësti i fundit, 23.000 USD, brenda datës 31.01.2004.

Deri në fund të vitit 2003 rezulton se janë paguar 77.000 USD për këtë pasuri.

1.9 Sipas analizës financiare të kryer për këtë periudhë për subjektin e rivlerësimit, pa llogaritur shpenzimet e tij për jetesë; shpenzimet e udhëtimeve; shpenzimet shëndetësore; shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, si dhe vlerën e arredimit të banesave në Rr. “****” dhe apartamentit në Rr. “****” (marrja në konsideratë e të cilave do të shtonte edhe më shumë pamjaftueshmërinë me të ardhura të pagesave, kursimeve dhe shpenzimeve për këtë periudhë), ka pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, e cila nuk justifikohet nga të ardhurat në atë periudhë, referuar analizës financiare sipas tabelës së mëposhtme:

Tab .1 Analizë financiare, periudha 1991- 2003.

Pagesa		Të ardhura	
Përshkrimi	Vlera në lekë	Përshkrimi	Vlera në lekë
Pagesë për blerje shtëpi në Rr. “****”	95.884	Të ardhura neto paga	14.372.611
Pagesë blerje truall, Velipojë (5.000USD)	728.572	Ndryshim likuiditet Intesa Sanpaolo Bank (01.01.1991- 31.12.2003)	-6.818.673
Pagesë apartament 3+1 Rr. “****” (41.000USD)	5.658.000		
Pagesë 2 këste apartament Rr. “****” (77.000 USD)	10.291.050		
Pagesë, deklaruar blerje autoveture “Benz 190”	300.000		
Pagesë, deklaruar blerje autoveture “Volkswagen Passat”	250.000		
Pagesë, deklaruar blerje autoveture “Suzuki”	801.900		
TOTAL	18.125.406	TOTAL	7.553.938
Pagesa për pasuri të pajustificuara nga të ardhurat			-10.571.468

1.10 Për sa më sipër, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri në lidhje me:

- Mospërputhjet për sipërfaqen dhe numrin e apartamenteve në këtë godinë;
- Mospërputhjet për mënyrën e pagesës dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme.

1.11 Në përgjigje të barrës së provës, për mospërputhjet për mënyrën e pagesës dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme, subjekti i rivlerësimit deklaroi se në vazhdim të kontratës së sipërmarrjes për njësinë në fjalë, lidhur në nëntor të vitit 2002, u lidh një aneks-marrëveshje mes tij, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. P. F, për rregullimin e detyrimeve të ndërsjella, mbi bazën e së cilës rezultonte se i kishte mbetur pa paguar ende një detyrim prej 10.000 USD, detyrim i cili është shlyer më pas, sipas konfirmimit që jep z. P. F në deklaratën noteriale.

1.12 Në përgjigje të barrës së provës, për mospërputhjet për sipërfaqen dhe numrin e apartamenteve në këtë godinë subjekti i rivlerësimit deklaroi se nga të gjitha të dhënat, rezulton se sipërfaqja totale e njësisë është e njëjta dhe nuk ka pasur mospërputhje deklarimesh. Shoqëria *** sh.p.k, i është referuar tërësisë së sipërfaqes së njësisë së banimit, që përfshin dy apartamentet. Në deklaratën noteriale të bërë nga ana e administratorit të kësaj shoqërie, konfirmohet se nga kjo shoqëri janë marrë dy apartamente. Arsyeja përse në kontratën e qirasë është pasqyruar sipërfaqja totale e apartamenteve vjen nga referimi tek kontrata e sipërmarrjes si dokument themelor për të justifikuar pronësinë e qiradhënësit, meqenëse këto dy apartamente nuk ishin regjistruar akoma në ZRPP.

2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve

- Shkresë e Komisionit me nr. ***, datë 29.12.2017;
- Shkresë nr. *** prot., datë 08.01.2018, shoqëria “****” sh.p.k.;
- Shkresë me nr. *** prot., datë 11.01.2018, ZVRPP Tiranë;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. ***, datë 12.01.2018, OSHEE;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. ***, datë 01.02.2018, OSHEE;
- Shkresë kthim përgjigje e datës 31.01.2018, e noteres M. Sh;
- Deklarata e pasurisë së subjekti të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- Deklarata e interesave private para fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së me nr. ***indeksi;
- Deklaratat e interesave private periodik/vjetor nga 2007-ta deri në 2016-ën, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar;
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe prova të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike;
- Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 16.07.2018;
- Deklaratë noteriale e z. A. H, nr. *** rep., nr. ***kol., datë 05.07.2018;
- Kontratë sipërmarrjeje, datë 15.11.2002, midis shoqërisë “****” sh.p.k. z. Artan Zeneli;
- Certifikatë vërtetim pronësie për sip. 60.17 m², nr. ***;
- Certifikatë vërtetim pronësie për sip. 135.72 m², nr. ***;
- Certifikatë vërtetim pronësie për sip. 135.72 m², nr. ***, + kartelë pasurie;
- Certifikatë vërtetim pronësie për sip. 60.17m², nr. ***, + kartelë pasurie;
- Aneks-kontratë, datë 09.06.2005, e “****” sh.p.k., z. P. F, z. Artan Zeneli;
- Mandatarkëtimi nr. ***, datë 15.11.2004, vlera 47.000 USD;
- Mandatarkëtimi nr. ***, datë 15.11.2002, vlera 5.000 USD;
- Mandatarkëtimi nr. ***, datë 15.03.2005, vlera 38.000 USD;
- Aktmarrëveshje nr. ***, datë 14.04.2005, midis z. P. F dhe z. A. G;
- Vetëdeklarim legalizimi, subjekti ndërtues “****” sh.p.k.;
- Deklaratë noteriale, datë 10.02.2017, shtojcë aktmarrëveshjeje, datë 10.02.2017;
- Deklaratë noteriale e z. P. F, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.03.2017;
- Deklaratë noteriale e z. P. F, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2018;
- Akti ekspertimi, shoqëria “****”, ekspert T. G
- Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, nr. *** rep., *** kol., datë 11.05.2017.

Trupi gjykues i konsideroi marrjet e dëshmime të z. A. H, administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., dhe z. P. F si të panevojshme për vendimmarrjen, pasi ka marre si provë deklaratat noteriale të tyre.

Trupi gjykues e konsideroi të panevojshme kryerjen e veprimeve procedurale për këqyrjen në vend të pasurisë: Apartament banimi, me sip. 212.66 m², ndodhur në Tiranë, Rr. “****”, Pall. “****”, për arsye se fakti që kërkohej të provohej, rezultoi i provuar gjatë gjykimit.

3. Arsyetimi ligjor

3.1 Në lidhje me mospërputhjet për sipërfaqen dhe numrit të apartamenteve në këtë godinë:

Trupi gjykues, pasi administroi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për sipërfaqen e kësaj banese dhe ndarjen e saj në dy banesa, i konsideron ato të plota, duke e quajtur të provuar të kundërtën e barrës së provës, për këtë pikë të rezultateve të hetimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli.

3.2 Në lidhje me mospërputhjet për mënyrën e pagesës dhe pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për këtë pasuri:

3.2.1 Aneks-marrëveshja mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. P. F e z. Artan Zeneli, për rregullimin e detyrimeve të ndërsjella është bërë e njohur për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit, vetëm pas kalimit të barrës së provës për këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë këtë aneks-marrëveshje, që nuk është paraqitur më parë as në Deklaratën-Vetting, as në përgjigje të pyetësorëve.

3.2.2 Ky deklarim bie ndesh me çfarë ka deklaruar vetë subjekti i rivlerësimit në pyetësin e dytë, se pagesat janë kryer sipas kontratës së sipërmarrjes.

3.2.3 Deklarata noteriale e z. P. F ka vlerë të kufizuar provuese, pasi është bërë nga njëra prej palëve në kontratë dhe një person në marrëdhënie shoqërore me subjektin e rivlerësimit dhe është bërë më pas, sipas kërkesës të vetë subjektit të rivlerësimit.

3.2.4 Pas analizimit të akt-ekspertimit të ekspertit kontabël T.Gj., për të provuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, rezultoi se:

-Për kryerjen e ekspertimit nuk është përmendur asnjë standard auditimi referues për mënyrën dhe zhvillimin e ekspertimit; dhe janë përdorur të dhëna referuese të ndryshme për kohën dhe vlerat e paguara;

- Deklarata noteriale e z. P. F ka vlerë të kufizuar provuese, sipas shpjegimeve të pikës “3.2.3”. Në këto kushte, edhe akti i ekspertimit i bazuar mbi këtë deklaratë, do të ishte i kufizuar në fuqinë e tij provuese;

-Në akt-ekspertim janë analizuar shpenzimet e familjes së subjektit të rivlerësimit, duke përcaktuar vetëm se për një periudhë 25-vjeçare kjo familje ka 55.314.982 lekë shpenzime, pa bërë llogaritje të saktë se si është arritur në një vlerë të tillë dhe pa e shoqëruar këtë llogaritje me dokumentacion ligjor provues;

-Ky akt ekspertimi nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

1. Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuar së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me nenin D, paragrafi 3, i Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur, ose ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (iii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

V. Apartament me sip. 74 m², në *, Kavajë, kompleksi “****”, vlera 45.500 euro.**

Burimi i krijimit i deklaruar në Deklaratën-Vetting:

- Kontratë huaje me bankën “Emporiki”, për kredi në shumën 40.000 euro.

- Të ardhurat nga puna si avokat dhe paga e bashkëshortes.

1.Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Në Deklaratën-Vetting, subjekti i rivlerësimit deklaroi apartament me sip. 74 m² në ***, Kavajë.

1.2 Në deklarin periodik të vitit 2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament 2+1, me sip. 90 m² + tarracë, 74 m².

1.3 Shoqëria “****” vuri në dispozicion të Komisionit planin e riveimit, sipas kontratës për ndërtim apartamenti, datë 28.06.2006, të lidhur me klientin Artan Zeneli.

1.4 Në pyetësorin drejtuar subjektit, lidhur me këtë pasuri, ai u pyet: “Për këtë pasuri, në deklaratën e interesave private të vitit 2007 deklaroni “Apartament 2+1, me sip. 90 m² + tarracë 74 m²”. Sa është sipërfaqja e pasurisë suaj të ndodhur në këtë adresë?”

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti deklaroi se sikundër e ka sqaruar edhe më përpara pranë ILDKPKI-së, ka pasur një pasaktësi për sipërfaqen prej 90 m². Sipërfaqja e saktë është 74 m² banesë dhe 74 m² tarracë”.

1.5 ILDKPKI-ja pas kërkesës nga Komisioni vuri në dispozicion shpjegimet e dhëna në këtë institucion (ILDKPKI) nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nga të cilat nuk rezultoi të jenë dhënë shpjegime lidhur me sipërfaqen e kësaj pasurie, sikundër pretendohet nga subjekti i rivlerësimit.

1.6 Iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit në lidhje me deklarinet kontradiktore në raport me sipërfaqen e këtij apartamenti.

2. Provat e administruara për vërtetimin e fakteve

- Shkresë kthim përgjigje, me nr. *** prot., datë 28.02.2018, shoqëria “****” sh.p.k;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 20.04.2018, ILDKPKI;
- Kontratë sipërmarrjeje, datë 28.06.2006;
- Planimetritë bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes;
- Shkesë nga ALUIZNI, kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 06.07.2018;
- Deklarata e pasurisë së subjekti të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016
- Deklarata e interesave private para fillimit të detyrës pranë ILDKP-së me nr. indeksi ***;
- Deklaratat e interesave private periodik/vjetor nga 2007 deri në 2016-ën, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar;
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe dokumentacionet e prova të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike. Parashtrimet e subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore 16.07.2018;
- Kontratë sipërmarrjeje, datë 28.06.2006. Planimetritë bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes;
- Shkesë kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 06.07.2018 ALUIZNI;
- Tabela për shlyerjen e kredisë “Emporiki Bank”;
- Shkresë kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 05.01.2018, ZVRPP Kavajë;
- Shkresë kthim përgjigje *** , datë 29.12.2017, ZVRPP Kavajë.

3. Arsyetimi ligjor

3.1 Subjekti i rivlerësimit konfirmon se nuk e ka deklaruar saktë këtë pasuri në Deklaratën-Vetting nëpërmjet shpjegimit se kjo pasuri nuk është regjistruar në regjistrat e pasurisë së ZRPP-së.

3.2 Ai e ka konfirmuar nga ALUIZNI-it, dhe shpjegon se pas këtij konfirmimi, nëse në të ardhmen do të regjistrohet, sipërfaqja e banimit për këtë pasuri do të jetë 74 m², edhe ajo e tarracës do të shënohet 74 m².

3.3 Subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë reale ta pasqyronte saktësisht këtë pasuri në Deklaratën-Vetting, si dhe të kërkonte të njëjtin konfirmim që mori nga ALUIZNI përpara

plotësimin të Deklaratës-Vetting, në mënyrë që faktet e pasqyruara në këtë deklaratë të ishin të sakta.

3.4 Shpjegimi se, në të ardhmen kur të regjistrohet, sipërfaqja e banimit do të jetë 74 m², edhe ajo e terracës do të shënohet 74 m², nuk e përjashton atë nga detyrimi i deklaramit të saktë të kësaj sipërfaqeje në plotësimin e Deklaratës së Pasurisë-Vetting.

3.5 Objekt i deklaramit, sipas nenit 3, pika 11, të ligjit nr. 84/2016, janë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

3.6 Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e pasqyrimin të të dhënave të sakta në Deklaratën e Pasurisë, të plotësuar sipas “Shtojcës nr. 2” të ligjit nr. 84/2016.

3.8 Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se, nuk e ka deklaruar saktë këtë pasuri në Deklaratën-Vetting pasi kjo pasuri nuk është regjistruar në regjistrat e pasurisë së ZRPP-së, është i pambështetur në ligj e në prova.

4. Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë

Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Nuh Zeneli, nuk arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë pasi: ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë; nga kontrolli i pasurisë u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht; u evidentua se ai ka ndërmarrë hapa për të fshehur, ose ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij.

Në zbatim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës ndaj tij zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet e provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë rezultateve të hetimit.

KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, bazuar në pikën 2 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e germës “g” të kreut V “Të dhëna për sigurinë”, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

(iii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe deklarim të rremë në Deklaratën-Vetting, për burimin e krijimit të këtyre pasurive.

(iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, DH, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 58, pika 1/ c dhe nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 18.07.2018.

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA

Anëtare / Kundër

Valbona SANXHAKTARI

Relatore

Xhensila PINE

Sekretare gjyqësore

Anisa DUKA